



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:017274
Datë: 05.12.2024
Numri i dokumentit: 06550709

Në çështjen juridike të : AC-I-24-0309-A0001

Paditësi

F F fshati B, Podujevë

Kundër:

E paditura/Ankuese

N.SH FAN “Zahir Pajaziti” (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Asllan Krasniqi, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-5848, të datës 29 mars 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 5 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.
2. Anullohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-5848, i datës 29 mars 2024.
3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së tek gjyqtari/ja përkatës.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 14 gusht 2014, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0115 të datës 12 korrik 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 1,656.66 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak të parashkrimit. Gjithashtu kishte paraqitur ankesë edhe ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0116 të datës 21 korrik 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në një shumë të pacaktuar, ishte refuzuar si e pavlefshme gjithashtu për shkak të parashkrimit. Në ankesë paditësi kishte theksuar se shpreson që të procedohet lënda e tij sa më shpejtë për arsye se është në gjendje të rëndë shëndetësore. Gjithashtu kishte kërkuar që të lirohet nga çdo taksë dhe kërkesa e tij të realizohet.

Ankesës i kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0115 të datës 12 korrik 2014 dhe PRN046-0116 të datës 21 korrik 2014 si dhe certifikatën mbi kohën e papunësisë.

Me datë 31 janar 2020, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit për AKP-në është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 31 të Ligjit për DHPGJS i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me ligjin për AKP-në. Gjithashtu pala kundërshtare kishte theksuar se natyra e lëndës është përsëritëse, pra ka një jurisprudencë të konfirmuar disa herë të DHPGJS e cila trajton këto lloj pretendimesh. Parashtruesi pretendon se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e ka për obligim t'i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me "Afatin për parashtrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Qëndrimi i palës kundërshtare është se afati i parashkrimit nuk e lejon AL-në ose DHPGJS-në që të analizoj dhe shqyrtoj meritat e rastit. Andaj, e paditura i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të

vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 26 maj 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5848 e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit. Kjo për faktin se kishte vlerësuar se kërkesa e paditësit ishte parashkruar dhe se i njëjti nuk ka pohuar ndonjë fakt relevant apo argument ligjor që do të bënte ndryshimin e rrethanave faktike sa i përket parashkrimit të së drejtës përr të kërkuar në rrugë gjyqësore pagat e papaguara dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Me datë 3 qershor 2022, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-5848 të datës 26 maj 2022, në të cilën kishte theksuar se i njëjti ishte punëtor i N.SH-së deri në ditën e privatizimit të saj dhe se i njëjti ka të drejtë ti kompensohen pagat e papaguara për periudhat e cekura në ankesë. Gjithashtu i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e tij si e bazuar ose të priset aktgjykimi i ankimuar ose lënda të kthehet në rigjykim duke e detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të pagave të papaguara t'i kompensoj paditësit për periudhën dhjetor 2002 deri në mars 2003, janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, shumën prej 1,656.66 euro dhe interesin ligjor prej 10%, duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës. Ankesës i kishte bashkëngjitur autorizimin për përfaqësim, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, listën e rrogave të mbetura borxh për punëtorin F F të datës 24 mars 2006.

Me datë 1 gusht 2022, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit duke i propozuar Kolegjit të Apelit që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar. Përgjigjes i kishte bashkëngjitur vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit të datës 1 maj 2021.

Me datë 13 korrik 2023, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-22-0305 kishte aprovuar ankesën e paditësit si pjesërisht të bazuar duke ndryshuar Aktgjykimin e ankimuar dhe duke obliguar të paditurën që në emër të pagave të papaguara për muajin mars 2003 për periudhën janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, t'i paguaj paditësit shumën prej 1,139.55 euro, interesin ligjor prej 10% në shumën prej 113.00 euro dhe shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 208.00 euro, ndërsa, kishte vërtetuar Aktgjykimin e ankimuar sa i përket pjesës tjetër të kërkesës për pagat e kërkuara për muajin dhjetor 2002, janar e shkurt 2003. Sa i përket pjesës së kërkesës së paspecifikuar për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës të refuzuar nga AL me

vendimin PRN046-0116 të datës 21 korrik 2014, lëndën ia kishte kthyer gjyqtarit përkatës të shkallës së parë në rigjykim. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se Kolegji i Apelit ia kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim të pagave të papaguara si më lartë duke u bazuar në listën e nënshkruar nga menaxhmenti i N.SH-së sipas të cilës paditësit i janë mbetur borxh pagat si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, ndërsa pjesa e mbetur kishte konstatuar se është e parashkruar andaj si e tillë më të drejtë është refuzuar nga ana e shkallës së parë. Sa i përket kërkesës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës Kolegji i Apelit kishte vlerësuar se shkalla e parë në rigjykim duhet të lëshoj urdhër që paditësit t'i jepet rasti të specifikoj shumën e kërkesës për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Me datë 21 korrik 2023, gjykata kishte lëshuar një urdhër C-IV-14-5848 për paditësin nga i cili kishte kërkuar që në afat prej 7 ditëve të dorëzoj prova shtesë me të cilat duhet të vërtetohet shuma e paspecifikuar për vendimin me nr. PRN046-00116 të datës 21 korrik 2014 kundër të cilit është ushtruar ankesa.

Me datë 31 korrik 2023, paditësi duke iu përgjigjur urdhrin të lartcekur kishte dorëzuar në gjykatë këto prova: vërtetimin për përvojën e punës së paditësit, kopjen e librezës së punës së paditësit, listën përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave të 20%, listën me llogaritjen e tri pagave të papaguara nga N.SH për punëtorin F F, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006 si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0116 të datës 21 korrik 2014.

Me datë 29 mars 2024, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5848 kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e paditësit dhe kishte ndryshuar vendimin e AL-së me nr. PRN046-0115 të datës 21 korrik 2014, ashtu që kishte obliguar të paditurën që ankuesit në emër të kompensimit për paga të papaguara t'i paguaj shumën prej 1,656.66 euro dhe në emër të interesit ligjor prej 10% shumën prej 165.66 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi ishte theksuar se nga listë pagesa vjetore ishte vërtetuar fakti se ankuesi kishte paga të papaguara nga N.SH në shumën prej 1,656.66 euro. Gjykata i kishte pranuar si prova relevante dhe të bazuara listën e pagave vjetore për vitin 2004 dhe 2005, vendimin mbi përvojën e punës, librezën e punës, vendimin mbi lartësinë e pagës, letërpezullimin e datës 24 mars 2006, për të arritur në përfundim se ankuesi ka ofruar shërbime pune për N.SH për periudhën janar 2004-dhjetor 2005 dhe se për këtë periudhë N.SH i ka mbetur borxh pagat. Tutje, kishte theksuar se ankuesit nuk i është paguar dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës i cili ka kërkuar kompensim

në shumë të pacaktuar por në ankesë dhe në kërkesën e dërguar në AL nuk e kishte theksuar shumën e kërkuar për kompensim për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Me datë 18 prill 2024, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-5848 të datës 29 mars 2024 (aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që kthej në rivendosje aktgjykimin e ankimuar ose të aprovohet kërkesa për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë se ekzistojnë dy afate të ndryshme të parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit e ka për obligim t'i pranoj dhe përmes të cilave Autoriteti i Likuidimit aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me "Afatin për parashtrimin e kërkesave" që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurë të likuidimit dhe afati i dytë që ka të bëj me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar të zbatohet në kërkesë. Dy afatet e lartcekura janë të ndara dhe të dallueshme dhe një kreditor duhet t'i përmbushë të dy afatet në mënyrë të kërkesa e tij të pranohet. Andaj, Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj ex officio. Ankuesja i kishte propozuar Kolegjit të Apelit që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të priset vendimi i Autoritetit të Likuidimit ose lënda të kthehet në rivendosje ose të aprovohet kërkesa për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0115 të datës 21 korrik 2014.

Me datë 6 nëntor 2024, paditësi kishte paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës në të cilën i propozon Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të refuzohet si e pabazuar ankesa e ankuesit, ndërsa të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar dhe të detyrohet e paditura të bëj kompensimin e shpenzimeve të përfaqësimit në shumë prej 208.00 euro.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj si i tillë duhet të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjyqtarit përkatës në shkallë të parë.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 1,656.66 euro (PRN046-0115) si dhe kërkesa e paditësit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në një shumë të pacaktuar (PRN046-0116), ishin refuzuar si të pavlefshme për shkak të parashkrimit.

Me datë 26 maj 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-5848 e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit me arsyetimin s i njëjti nuk ka pohuar as paraqitur ndonjë fakt relevant që do të ndikonte në vendosjen ndryshe të kësaj çështje.

Me datë 3 qershor 2022, paditësi kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur me pretendimin se i njëjti ka të drejtë në kompensimin e pagave të papaguara dhe i kishte bashkëngjitur këto prova: njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 24 mars 2006, listën e rrogave të mbetura borxh për punëtorin F F të datës 24 mars 2006.

Me datë 13 korrik 2023, Kolegji i Apelit me Aktgjykimin AC-I-22-0305-A0001 kishte aprovuar ankesën e paditësit si pjesërisht të bazuar dhe kishte ndryshuar Aktgjykimin e ankimuar dhe Vendimin e AL PRN046-0115, ashtu që kishte obliguar të paditurën që në emër të pagave të papaguara për muajin mars 2003 për periudhën janar-mars 2004, dhjetor 2004 dhe janar-mars 2005, t'i paguaj paditësit shumën prej 1,139.55 euro.

Ndërsa kërkesën për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, Vendimi i AL. (PRN046-116) në shumë të paspecifikuar, lëndën ia kishte kthyer gjyqtarit përkatës të shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata përmes një urdhri kishte kërkuar nga paditësi që të dorëzoj prova shtesë dhe të specifikoj shumën e paspecifikuar për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Në rigjykim paditësi kishte specifikuar shumën e kërkuar dhe atë shumën prej 1,906.38 euro si dhe kishte bashkëngjitur këto prova: vërtetimin për përvojën e punës së paditësit, kopjen e librezës së punës së paditësit, listën përfundimtare të punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave të 20%, listën me llogaritjen e tri pagave të papaguara nga N.SH për punëtorin F F, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006 si dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN046-0116 të datës 21 korrik 2014.

Me datë 29 mars 2024, shkalla e parë e DHPGJS-së kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar ankesën e paditësit dhe kishte ndryshuar vendimin e AL-së me nr. PRN046-0115 të datës 21 korrik 2014, ashtu që kishte obliguar të paditurën që ankuesit në emër të kompensimit për paga të papaguara t'i paguaj shumën prej 1,656.66 euro pasi që paditësi kishte vërtetuar se N.SH i kishte mbetur borxh këto paga.

AKP-ja e kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të lartcekur me pretendimin se gjykata nuk ka vendosur lidhur me kërkesën për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës andaj Aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim në shkallë të parë.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se ankesa e të paditurës është e bazuar dhe lënda duhet t'i kthehet shkallës së parë të DHPGJS-së në rigjykim.

Kjo për faktin se lidhur me kërkesën e paditësit (PRN046-0115) për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 1,656.66 euro, është vendosur me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit, AC-I-22-0305-A0001 të datës 13 korrik 2023 dhe shkalla e parë ishte udhëzuar që pas lëshimit të një urdhri me anë të së cilit duhet të kërkonte nga paditësi specifikimin e shumës për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Paditësi në rastin konkret e kishte specifikuar shumën dhe kishte dorëzuar në gjykatë prova në mbështetje të pretendimeve të tij, mirëpo shkalla e parë përkundër udhëzimeve të Kolegjit të Apelit për të vendosur lidhur me kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës (PRN046-0116), përsëri kishte vendosur për kërkesën për paga të papaguara e cila tashmë është vendosur nga ana e Kolegjit të Apelit (PRN046-0115).

Pjesa e kërkesës për paga të papaguara sipas vlerësimit të Kolegjit të Apelit është çështje e gjykuar (res judicata), prandaj Aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjyqtarit përkatës në rigjykim.

Në rigjykim, shkalla e parë e DHPGJS-së udhëzohet që pasi të ketë shqyrtuar përgjigjen e paditësit në urdhrin C-IV-14-5848 të datës 21 korrik 2023, të vendos në merita të çështjes lidhur me kërkesën e paditësit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, për të cilën nuk është vendosur ende përkundër udhëzimeve të Kolegjit të Apelit me Aktgjykimin AC-I-22-0305-A0001 të datës 13 korrik 2023.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 5 dhjetor 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
